

DUART E ZHAGMITURA

ADEM ZAPLLUZHA

**DUART E
ZHAGMITURA**

Redaktor:
Gjokë Dabaj

Recensent:
Gjokë Dabaj

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

DUART E ZHAGMITURA

ADEM ZAPLLUZHA

**DUART E
ZHAGMITURA**

Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2020

Gjokë Dabaj

Lumenjtë që rrjedhin pakthyesëm

Që të analizohen dhe të komentohen poezitë e Adem Zaplluzhës, duhen vëllime qindra faqesh. Figuracioni i tij është i pambarimtë, pra, edhe zberthimi dhe sqarimi i atij figuracioni do të ishte edhe më i pambarimtë. Pothuaj secila fjalë e tija është një figurë e kjo do të thotë që aty, secila fjalë i ka një apo disa kuptime të bartur.

Natyrisht, unë s'do t'i hyj këtu një zberthimi të tillë tërësor. Do të ish i pamundur, por edhe i panevojshëm. Prandaj po ndalem fillimisht vetëm te "...*kori i bretkosave*". Ç'më kujton ky "*kor bretkosash*"? Mos vallë Aristofanin? Po, por këtu s'kanë gjë të përbashkët, përveç emërimit, i cili, edhe pa dashur, na e çon mendjen te njëri nga kulmet zanafillorë të artit botëror.

Këtu kemi të bëjmë thjeshtë me "*kulloso të virgjëra*" në prani të *bretkosave*. Një i dashuruar, çfarë "*kulloso*" te vajza që ka pranë? Një e dashuruar, ç' "*kulloso*" te djali që e do? Që të dy, atje ku zotat e kanë dhënë për së mbari, "*kullosin*" virgjërinë e njëri-tjetrit.

Muaj e vite do të kalojnë e ju nuk do t'i harroni ata çaste.

Shtojani kësaj edhe një situatë përqaqimesh nëpër shi! O zota! Mua më ka ndodhur vërtet! Kanë kaluar mbi 60 vjet dhe s'e kam harruar. I luteshim qiellit që të mos pushonte kurrë ai shi. Ndërsa dhentë, tufa-tufa, strukeshin ngjitur njëra me tjetrën, ne shtrëngoheshim dhe gëzoheshim që po lagemi. Trupi i saj, brenda një fustani krejt të hollë, nxirrte avuj. (Ka vite që ai trup s'është më në këtë jetë.)

“*Qanim në duet me shirat*”. Në të vërtetë, rigat e shiut na kullonin nëpër flokë, rridhnin te balli dhe, mu poshtë syve, na ngjanin me lot. Por s'ishin lot. Ishin “*stërkalat*” që “*ledhatonin lëkurën e zeshkët*”.

Cilit djalë të ri nuk do t'i dukej sikur është ai, që e ka zbuluar universin i pari? Dhe cilit djalë, në ato rrethana ndjenjash të pafrenueshme, nuk do t'i dukej vajza që ka pranë, si qenia më kryesore e gjithësisë? Në mos e vetmja, e zbritur aty enkas për të!?

Vajza, (kjo e kësaj poezie), i ka xhepat të grisur. Prej tyre rrjedhin çurgjet e ujit. Çurgje uji i dalin edhe prej flokësh, dhe djalit i duket sikur po pikojnë yjet.

Janë çaste që kurrë më nuk përsëriten. Kthehuni dhe rilexojeni! Poezia titullohet „*Vetëm kori i bretkosave*“.

E këtillë është krejt poezia e Adem Zaplluzhës. Cilindo krijim të tijin do ta përjetojmë pikërisht kështu. Janë 22 krijime te ky cikël, me titull „*Ti ishe pema*“, dhe secili na fton t'i rikthehemi nga disa herë. Hape në cilëndo faqe!.. Ja, u hap në faqen 18! „*Nga një puthje gjumë shkatërruese*“. A mund të largohesh pa e lexuar disa herë?!

Në një vend tjetër, për shembull, në faqen 24: //„*U puthëm nën ura,/ E deshëm njëri-tjetrin/ Si ditëm vetë./ Na ndihu fati që jemi gjallë*“//.

Te cikli i dytë, titulluar „*Përmendoret meritojnë më shumë*“, Adem Zaplluzha na shfaqet si një Migjen i shekullit 21. Një poet i mjerimit të shqiptarëve, edhe mbas njëqind vjetëve!? A është e arsyeshme dhe e pranueshme që Kombi ynë, edhe mbas njëqind vjetësh, të jetojë jetë lypsarësh nëpër lagje të varfra?! Jetë skamnorësh, si njëqind vjet më parë, ashtu edhe sot!? Pleq të lënë në mëshirën e fatit! //„*Biro, lëri ata qejfet e tu!/ Unë nuk kam asnjë lek.*“//. Ky cikël ka 27 poezi. Secila më e rëndë se tjetra.

„Një nënë me gjinj prej rëre“. A mund ta konceptojë dikush një grua, aq më tepër një nënë, e cila, në vend të qumështit, e ka gjoksin të mbushur me rërë?! Krejt kjo pjesë e këtij libri ka disa portrete nënash, rënë në gremina mjerimesh. Janë, në mos gabohe, nja 15 krijime-skëterrë, që flasin për nëna të këtilla. Shumica e tyre kanë të bëjnë me përmendoret. Janë nëna heronjsh dhe, pikërisht këtu mbështillet mllefi i revoltës, edhe i poetit, edhe i lexuesit. Nënata e heronjve, të braktisura si mos më keq!

//“E njoh mirë shpirtin e saj:/ Është një Nënë e Madhe,/ Të cilën sot/ Askush nuk e vëren.”//. //”...ia mbulon shpatullat/ Një këmishë e grisur.”// Pak më tutje një tjetër nënë, ose ndoshta po ajo, shtrin vetëm dorën e majtë, sepse e djathta i mungon. I biri, ndërkaq, //”Vetëm si përmendore/ Mund t’ia ofrojë/ Përqaqimin e bronzte...”//. Prapë një nënë, //”pa asnjë djalë! //...Të vetmen vajzë që e kish pasur”// e ka humbur diku në Koshare. E tash ...//”Kalon çdo ditë/ Prej një tavoline në tjetrën,/ Duke u takuar/ Me mosmirënjohjen e njerëzve.”//. Lemer!

Ç’është gjithë ky trishtim i pangushëllueshëm për nënat shqiptare?! Mos na fshihet këtu një simbolikë më madhore se

ajo e një nëne personale, qoftë edhe nënë heroi?! Mos është këtu, e pasqyruar kaq dhimbshëm dhe kaq alarmante, vetë Shqipëria?! Dua të them, krejt Shqipëria, e bërë copash! Një Shqipëri e shkallmuar dhe e shpërndarë në gjashtë shtete!?

I kemi disa poetë, që Shqipërinë e kanë quajtur *Nënë*. ...Ndre Mjeda, Dritëroi... Tash, mos ka ardhur koha që çdo shqiptar ta quajë *Nënë* këtë lëkurë toke, mbetur ende gjallë?! Ta quajmë *Nënë*, por jo ta lëmë të endet rrugëve, duke u druajtur se mos “*Copën e mykur të bukës*” ia grabisin qentë endacakë, që bredhin kontinenteve për të zhvatur ç’të mundin! Është poezi tepër serioze!

Në pjesën e tretë, me titull “*Duart e zhagmitura*“, titull që ia ka vënë emrin krejt librit, Ademi ka përfshirë nja 16 krijime, që të gjithë të një shkalle të lakmueshme.

Siç edhe mund të pritej, temat e këtyre poezive janë të ndryshme: tema të përgjithshme me sens filozofie, tema që lidhen drejtpërsëdrejti me Kombin, me Atdheun, gjithmonë të tejmbushura me brengë. //”*Mermerët e kuq të Kosovës./ Kuq*

si gjaku i përgjakur!”//...//Asnjëherë s’e kuptova/ Në cilën kohë po jetojmë.”//

Lajtmotivin e krejt këtij vëllimi e ndoshta të krejt poezisë që e ka krijuar deri më sot ky poet i papërsëritshëm i gjenisë krijuese shqiptare, e ka, pa dyshim, poezia “*Duart e zhagmitura*”.

Ç’janë këto *duar të zhagmitura*? Ç’është kjo fjalë? Ku e ka gjetur këtë relikte midis mijëra relikteve të gjuhës shqipe?! Një fjalë që s’ta merr mendja se gjendet nëpër fjalorë e, megjithatë, ajo është aty dhe tregon: *diçka të shkalafitur, diçka dhunshëm të copëtuar*.

Por, as vetë krijuesin e më shumë se 170 librave, Adem Zaplluzhën, s’e gjen dot lehtë në katër anët e dheut ku banojnë shqiptarët. Adem Zaplluzhën. Me një stil modern, ashtu siç edhe po e kërkojnë brezat që kanë ardhur me ne e mbas nesh, me një figuracion stilistik të ngjeshur e gati të papërsëritshëm, por pa u shkëputur nga tradita e nga tabani, në të cilin është mbrujtur kjo poezi ndër shekuj, qysh prej Homerit e këndej. Adem Zaplluzhën, veprën e të cilit duhet ta lexojmë e rilexojmë, për të ndjerë shumë më tepër, por edhe për të ditur shumë më tepër.

Me Ademin unë e kam një lidhje të hershme dhe tepër të veçantë. Kemi qenë bashkënxënës në Shkollën Normale të Prizrenit në vitet 1961 e 1962, madje bashkanëtarë të rrethit letrar të asaj shkolle, në të cilin i patëm lexuar të parat poezi tonat. Kemi qenë pjesë modeste e një lëvizjeje të madhe në të mirë të Kombit e Atdheut. Të këtij Atdheu keqas *të zhagmitur!* Na vjen mirë që të paktën një pjesë e idealeve tanë u arritën, por, siç është krejt e natyrshme për njerëz që i kanë të mëdha dëshirat, na vjen keq dhe vuajmë për shumë gjëra që nuk u arritën.

Ndaj edhe po i lutemi, me këtë rast, rinisë sonë të sotme, në qiellin e së cilës një shumicë e saj janë „*yje klandestinë*“, të mos i nënvleftësojnë dhe të mos i qesin në harresë këto duart tona, rryeshëm *të zhagmitura*.

Lumenjve që rrjedhin pakthyeshëm, po u lutemi: Kur të zhyten në ujërat tuaj, mos i mbytni yjet tanë!

Pjezë, 17 maj 2019.

Cikli i parë
Ti ishe pema

MUNGOVE NË EKZISTENCËN E FURTUNËS

Nuk di:
Vallë, a iu tek botës
E më lindi mua
Në këtë kohë të shthurur?!
Dy duart e mia
Llapashiten si lopatat nëpër kujtesë!

Një hënë e virgjër,
Me sytë e saj të kristaltë,
Më shikon nga një largësi e pamat.
Më shikon,
Thua se kurrë nuk jemi takuar.
Mbase i ka harruar serenatat në shi.

Rri në mes të rrugës,
Rri, mbështetur pas drurit të kalbur.
Rri dhe shikoj
Hapësirën e ngrysur në horizont,
Duart e thyera të erës
Më përshëndesin me mallëngjim.

Ti nuk ishe askund,
Kur u krijua kjo botë e lajthitur.
Atë ditë mungove në sofrën
E fundit të pikëllimeve,
Mungove që në fillim
Në ekzistencën e furtunës.

YJET NA SHIKONIN ME XHELOZI

Ishe e bukur deri në mallëngjim.
Nga sytë e tu bojë deti
Pikonin të gjithë yjet e galaktikës.
Ishe yllesh, nga lotët e së cilës
Buronin margaritarët
E të dashuruarve.

Nuk jam më ai njeri i mëparshëm.
S'di me cilin yll
Të ta dërgoj
Kurorën e dashurisë,
Që të xhelozojnë perëndeshat e Olimpfit,
E dashura grua e përjetshme!

Më kujtohen çastet
Kur i krihnim flokët e shprishur
Të hënës lozonjare.
Yjet na shikonin me xheloz.
Shikonin
Hapat e sutës së egër,

Shikonin, duke vrapuar
Lëdinave të paprekura
Të vetëtimave.
Nga lëkura e zeshkët e ditës
Era atë ditë t'i lëpinte djersët.
Ti ishe dhe mbete yllesh
E paprekshme në imagjinatën time.

VETËM KORI I BRETkosAVE

Me muaj e vite
I kalëruam
Kuajt e egër të kujtesës.
Kullosat ishin të virgjëra.
Vetëm kori i bretkosave,
Shkelte nëpër syprinën e shiut.

Më kujtohen çastet
Kur qanim në duet me shirat.
Stërkalat ledhatonin
Lëkurën e zeshkët prej dielli,
Ti ishe kryefjala e universit
Të sapo zbuluar.

Nga xhepat e tu të grisur
Pikonin si xhevahiret...
Pikonin
Mbi flokët tanë yjet e një nate,
E cila kurrë më
Nuk përjetoi ringjalljen.

TI ISHE PEMA

Për befasinë e të gjithëve,
Nuk të kërkova më asnjëherë
Në shpirtin e gjelbërimit.
Ti ishe pema
Që me dashuri rritej në mua.

Të thashë *pema*,
Sepse, nga sytë dhe duart e tua,
Këputeshin të gjithë frytet
E një stine,
E cila u shndërrua në përmendore.

SA I THELLË ËSHTË DETI I FJALËVET TË THËNA

Kur thashë *të dua*,
M'u duk vetja aq qesharak,
Sa që kurrë më
Nuk munda t'i harroj
Ata çaste,
Sa banalë, po aq edhe madhështorë.

Dashuria është
Më shumë se një çast.
Ajo nuk thuhet me asnjë fjalë.
Vetëm në shikimet e tu kuptova
Sa i thellë është
Deti i fjalëve të thëna
Dhe sa të cekët janë premtimet e gjetheve.

Të kujtohet kur u shtange si përmendore?
Duart e tua u shëmbëllenin
Gjymtyrëve
Të statujave antike.
Heshte si sarkofagu i vjetër
Dhe kurrë më
Nuk i pamë zbritjet e meteorëve.

E PASHPJEGUESHME DERI NË PAFUNDËSI

Dashuria nuk është asht
Që thyen dhëmballë,
Por as mish
Që fshihet mes dhëmbëve.

Ajo është një ndjenjë delikate,
E ndjeshme deri në zenit
Dhe e pashpjegueshme
Përtej pafundësisë.

Kush nuk beson,
Mund t'i pyesë yjet klandestinë,
Kur galdojnë
Lakuriq hapësirave.

Le t'i pyesë kalimtarët e rastit!
Le t'i pyesë,
Bulevardeve të vetmuar,
Edhe hamejtë e qytetit!

2.

Dashuria, ah,
Kjo pëllumbeshë e ëndrrave,
Që mungon
Në brendinë e secilës krijesë!
U mungon
Më së shumti atyre
Që duken të dashuruar!

Ju thashë
Se dashuria nuk është asht,
As një copë mish!
Është një pemë e lashtë
Dhe tejet delikate,
Nga degët e së cilës,
Si xhevahir pikojnë çastet
E ndjesive hyjnore.

SA KËNAQËSI ISHTE TË QANIM NË SHI

Ata që dinë të japin,
dinë edhe të marrin, e dashur!
Aq sa dhe,
mbase po aq edhe more.
Kjo ndjesi klandestine
Fluturon
Prej zemrës në zemër
Gati në çdo kohë dhe stinë.

Kur të thashë *të dua*,
Unë të desha aq
Sa pata forcë
Ta dua vetveten.
Me tërë qenien time të komplikuar,
Të desha dhe sërish të dua...
Me të gjitha ato grindjet e tua.

Kur trokite në ëndrrat e mia,
ishte një ditë me të reshura.
Të kujtohet
Kur qanim në shi?
Qanim pa u bezdisur
Se dikush
Do na i shohë lotët.
Sa kënaqësi ishte të qanim në shi!

QË KISHIN NGA DY VRIMA

Të kujtohet, e dashur,
Loja e sumbullave,
Kur i këputnim nga gjokset
E njëri-tjetrit
Te udha në fund të fshatit?!

Si idhujt i adhuroja
Ato sumbulla të bardha
Që kishin nga dy vrima.
Kurse ti çmendurisht
Dashuroje ato të sedefat.

Duke lozur si zogjtë
Në pluhur,
Tinëzisht tjerëve,
I preknim gishtat,
Të paprekur gjer atëherë.

Kështu, në mbrëmje,
Kur ktheheshim në shtëpi,
Na pritnin fjalët qortuese.
Por ne nuk e çanim kokën:
Me padurim imagjinonim të nesërmen.

AQ SHUMË E DESHËM SHIUN

Nuk di, në kohën tonë,
Çfarë emri kishte shiu?
Ose ishte pa emër.
Por ne, gjithsesi,
Si pëllumbat e egër,
Loznim nën stërkalat e ngrohta.

Që nga ajo kohë,
Aq shumë e deshëm shiun,
Sa që, kur s'binde,
E thërrisnim
Me një thirrje të lashtë pagane,
Duke i rrahur me shkop
Llamarinat e ndryshkura mbi gardh:

Shi, shi! Lagna, o shi!

Thërrisnim deri vonë mbrëmjeve
Shiun e egër,
I cili kurrë s'përfillte lutjet tona.
Vetëm kur u tekej vetëtimave,
I njomte me afsh
Shpirtrat e pangopur të rrapeve.

TË URITURIT E MËNGJESEVE

Më kujtohet kur uleshim
Në rërën e njomur.
S'na pengonin furtuna e batica.
Në gjuhën e peshqve,
Bisedonim me koralet.

Na përcillnin këngët e blerta
Të algave.
Thellësia e detit
I kishte të gjitha bojërat e dynjasë,
Kurse ti bisedoje
Me gjuhë metaforash.

Zëri i kaltër i detit
Ishte fundosur në oqeanin tonë
Dhe me dashuri i ushqente
Të uriturit e mëngjeseve.

Dielli përcëllues endte...

Me xhelozi endte pëlhurën e kujtesës!
Brigjet ëndërronin kohërat,
Kur qanin dhe qeshnin vashat,
Si fëmijëria.
Ndërsa në zemër u ndizej dashuria.

NA NGROH AI ZJARR I OLIMPIT

Të kujtohet, e dashur, kur çapitnim
Nëpër udhët e baltosura,
Kurse shiu idhnak
Zgërdheshej me dashurinë tonë?!
Zgërdheshej,
Mbasi i xhelozonte pa masë,
Dukjet tona të hareshme.

Ne kurrë nuk ishim
Unë dhe ti.
Mes nesh, si aureolë perëndie,
Qëndronte dashuria,
E cila, edhe me varfërinë
Që na ndiqte,
Na mbante gjallë!
Ishim dy krijesa, me një mall!

Të kam pas thënë njëherë
Se kurrë nuk do të kemi dimër.
Na ngroh dashuria jonë!
Na ngroh ai zjarr i Olimpmit,
I cili, gjer më tani,
Pat ngrohur vetëm perënditë pagane.

FLUTUROJ LARTËSIVE

Nuk lindën rastësisht këto poezi!
Këto lindën nga zjarri,
I cili askënd nuk e dogji,
Përpos vetveten!
Ajo flakë e lashtë,
E cila digjte djaj edhe perëndi!

Kështu thoshte për fëmijërinë e saj
Emta ime!
Unë asaj i besoj shumë,
Se ka qenë e dashuruar,
Sa që dashuria e saj
Dogji një lumë!

Sa shumë i donte
Jetën dhe dashurinë
Ajo grua e madhe!
Sa që një ditë, nga dashuria,
U shndërrua në pëllumbeshë
Dhe fluturoi lartësive të kaltra!

TI JE GJELBËRIMI IM, E DASHURA IME

Adhuroj të bukurën,
Syrin e tretë të hënës,
muzikën e tejdukshme të yjeve
dhe buzët e tua të mishta, e dashur!

Adhuroj bimët kah rriten
Dhe qeshjen, e cila buron
Nga ujëvara e kujtesës!
Çdo gjë adhuroj që të përngjan ty!

I adhuroj pemët, e dashura ime!
Pranverën, verën dhe dimrin...
Në telat delikatë të kitarës,
Secila stinë je ti në qenien time!

O, sa shumë e dua gjelbërimin,
Myshqet që rriten
Në shpirtrat rrapeve!
Ti je gjelbërimi im, e dashura ime!

PUSHO, MOJ ERË, PUSHO

Pusho, moj erë, pusho!
Më lër edhe mua
T'i ledhatoj
Dhe t'i kreh mëngjeseve herët
Flokët e saj të mëndafshtë!

Pusho, moj stuhi, pusho!
Kur më përqafton
Afshi i saj i dashurisë,
Ledhatimet i tejkalojnë
Të gjithë uraganet e botës!

Ju thashë të pushoni!
Nëse mërzitet e dashura ime,
Do t'ju fus në një shishe të qelqtë,
Si djallin e zi
Që gruaja e futi në gastare!

Sonte nuk kam nevojë
Për dorën e askujt!
Më mjafton ajo e së dashurës!
O, ju lutem, pushoni njëherë,
Deri sa të zgjohet gjelbërimi në mua!

FUNDOSEM SI ANIJET KOZMIKE

E kuqja ose ngjyra rozë
E buzëve të tua,
I tejkalojnë
Të gjithë spektrat e ngjyrave:
Herë duken si diell
E herë si hëna në përfaqimin e eklipsit.

Një fushë mëllenjash,
Si një mal me drenusha të egra...
Kurse nata erotike
I mat hapat e meteorëve
Që bien pingul.
Bien mbi sipërfaqen e brishtë të tokës.

Bredh nëpër sytë e kaltër të pemëve,
Duke i përtypur rrënjët.
Fundosem diku thellë
Në fushën e paanë të ekstazës.
Si anijet kozmike fundosem
Në shpirtin e pafund të dashurisë.

**NGA NJË PUTHJE
GJUMËSHKATËRRUESE**

E veshur me një fustan të bardhë
U shëmbëllente zanave të mira
Të Alpeve.
I luta perënditë
Të më shitojë ajo
Me dashurinë e saj.
Por më shitoi
Shtojzovallja!

Nata ishte lakuriqe.
Nën pemët e shurdhëta
Dëgjohej një muzikë e metaltë
Dhe qeshja e saj ironike,
Si zëzëllimë blete
Nëpër hojet e dhimbjeve.

Heshta. Heshtí edhe ajo.
Rrënjët më shikonin me kërshtëri.
Pas pushimit njëshekullor,
U zgjua pranvera e fjetur.
U zgjua Borëbardha
Nga puthjet gjumë shkatërruese të kujtesës.

NËPËR GUAJT E KËRMIJVE

Brodhëm si njerëzit guvë kërkues.
Nëpër guajt e kërmijve
Ndërtuam ëndrra
Të pa ëndërrta.
Dashuruam si të marrë
Dhe në fund të udhës,
Hoqëm dorë.

Asnjëherë nuk ishim lakej,
Por as mbretër jo se jo.
Nga dashuria kërkua të pamundurën,
Duke mos denjuar
Të marrim vetëm aq sa u japim,
Të tjerëve.

Ishim si hijet e verbëta.
Nuk ecëm nëpër shtegun e vërtetë.
Nga duart tona i shtrydhëm
Të gjithë llojet e eliksireve,
Por kurrë nuk arritëm
Të shërohemi nga dashuria,
Në atë rrugëtim
Sy lëbyrët.

ASNJËHERË NUK PATE ZEMËR

Më duket se ishte vonë,
kur duart e mia
u kthyen në përjetësi.

Nuk di, ishte ditë e hënë
Apo e Premtja e Madhe,
por, gjithsesi,
ishte një ditë dhe çast i bekuar.

Më kujtohet si në ëndërr,
kur duart e mia
mbetën në flokët e tu kaçurrela.
Mbetën duke krehur
Imazhet e harruar të adoleshencës.

Shiko, se si kjo kohë hajdute
Përvidhet nëpër rrasat e kujtesës.
Ti ishe si perëndeshë,
Në fronin tim
Ndërtuar prej vuajtjeve.

Edhe sot ndjej dhimbje
Nga fjalët e tua të pathëna.
Asnjëherë s'pate zemër të thuash:
Ti je dashuri, i dashur.

FLUTURAT E KALTRA TË PUTHJEVE

Sa herë që më zë vetmia
Në tisin e trishtimit,
Ulem kacule,
Sepse vetëm në atë gjendje
Ndjej afshin e dashurisë së parë.

I shtrij duart deri te cepi i fundit
I vendlindjes,
Përqafoj Urën e Gurit,
Më dalin parasysh
Fluturat e kaltra të puthjeve.

Më kujtohet: Ishte vera e ngrohtë,
Kurse djersët, si llava e vullkanit,
Shpërthenin nga poret
E lëkurës së zeshkët
Të mështeknës.
Ndërsa selvitë e lagjes
Parakalonin në heshtje.

DY YJE NË HORIZONT

Është koha për dashuri!
Ditë agjërimi!
Kjo ditë e shenjtë
Na shikon tërë galdim me një sy.

Nga guajt e yjeve
Zbresin me miliona grimca.
Zbresin kalorësit e sedeftë,
Për t'u ulur në sofrën e dashurisë.

Hëna nazeqare, po ashtu,
edhe lakuriqe,
me kërshtëri përcjell
të rrahurat ritmike të zemrave.

Dy yje në horizont,
Si dy këndesa të egër,
Zgjojnë mëngjesin e fjetur.
Zgjojnë, nga një ëndërr e kotur!

KËSHTU KJO BOTË, SI NË KURTH

Ne nuk deshëm të derdhim lot
Asnjëherë për dashurinë.
Gjithmonë menduam
Se burrat kurrë nuk qajnë.

Sa qesharakë që ishim!
Për dashuri, o vëlla i mirë,
Qajnë muri e guri!
Qajnë lumi dhe deti...
Për besë, edhe deti!

Mbase tani jemi zbutur
Të gjithë nga pak:
Dënesim me lot e pa lot,
Sa që dukemi tragjikomikë.

Njëra dashuri na kall flakë
E tjetra na përvëlton!
Kështu kjo botë, si në kurth,
Shpirt e mendje...
Na i tej shtrëngon.

DASHURUAM, SI LAKEJ E SI MBRET

Poshtë meje,
Një hapësirë boshe:
Sterra përtypet
Si një ka i plakur.

Më tutje,
Në një qoshe,
Puthet një djalosh
Me një gjyshe.

Nuk po di
Kush më shtyu
Ta shkruaj
Këtë satirë.

Por jeta
Më është shtrydhur,
Si në makinë,
Një peshqir!

U puthëm nën ura,
E deshëm njëri-tjetrin
Si ditëm vetë.
Na deshi fati që jemi krenarë!

Dashuruam si lakej,
Por edhe si mbret,
Pa e harruar kurrë
Drithërimën e parë.

Cikli i dytë
Përmendoret meritojnë më shumë

NJË NËNË ME GJINJ PREJ RËRE

Para syve të zgërlaqur,
Një det pikëllimesh
Dhe duarsh të shtrira!
Skamja fryn pa mëshirë
Nga të gjitha grykë erërat!

Veriu dhe jugu
Po i mprehin thikat e ndryshkura,
Nëpër lagjet e evgjitëve
Nuk mejnë piskamat e violinave:
Natë e ditë vajtojnë tingujt e urisë!

Rrugëve të ngushta të kasabasë
Bredhin minjtë lukuni,
Po ashtu bredhin edhe macet:
Si flamuj të grisur
Duken mbi çatitë e rrënuara.

Varfëria i ka lëshuar rrënjët!
Deri në shtatë pash dëgjohen gjëmat!
Dëgjohen gjëmat tronditëse të skamjes!
Një nënë me gjinj prej rëre
Shkul flokët në një skutë të faltores!

POETI I MOÇËM I SKAMJES

Në shpirtin e varfërisë
Dridheshin e përdridheshin
Rropullitë, si cunami.
Mbase qenka ky
Fillimi i legjendës për kripën.

Flamujt e atdheut të etërve
I grisin kujtimet
E kohërave të mira.
Një gjëmë e padëgjuar
Buron nga thellësia e mureve.

Kambanat nuk bien për mirë.
Për çdo ditë të lume,
Orë e çast,
Nëpër lagjet e skamnorëve,
Stiva arkivolesh, nxjerrë në shitje.

Mbrëmë vdiq edhe miku im,
Poeti i moçëm i varfërisë,
Pena e të cilit, me krenari
Lëronte pa mëshirë
Mbi egërsitë e të kamurve.

DËGJOHEN LEHJET E LASHTA

Dy palë daulle në një mëhallë,
Si përnatë,
U dëgjuan dhe mbrëmë.
Një njeri e përcillnin „me muzikë“
Deri te banesa e amshimit,
Një tjetër njeri po martohej,
Me shtatë daulltarë.

Ja, se si duket ky qyteti im:
Nën një çati
S'ndalen vigmat e vajeve,
Nën tjetrën çati
S'prajnë gjithë natën lehjet e vrazhda,
Lloj-lloj muzikash të shthurura
Dhe tejet ironike.

Nga katet e sipërm të qiellit
Shikojnë yjet klandestinë.
Shikojnë sagën e mjerimit,
Azdisur rrënjësh në qindra vjet
E s'paska të ndalur!
Medet për ne!

ME NJË KËMISHË TË GRISUR

Mbi një trastë të vjetër,
Vendosi një copë gazetë.
Mendoi ashtu të mos i derdhet...
Mëshira e të pasurve.

Hapat e rëndë kalojnë në heshtje.
Me dorën e saj të shtrirë
Mbi trotuaret e qullur,
Shikon, me sy të përhumbur,
Sytë e kalimtarëve,
Që i rrëshqasin për së kithi
Me mospërfillje.

Ndërkaq, dora e zgjatur,
Pa mëshirë laget
E qullet
Nën shiun e acartë të vjeshtës.

Qullet edhe shpirti i saj,
Nga skamja i mardhur.
E njoh mirë shpirtin e saj:
Është një Nënë e Madhe,
Të cilën sot
Askush nuk e vëren.

Për çdo ditë e shoh atë Nënë,
Atë Grua,
Te përmendorja,
Kah ia mbulon shpatullat
Një këmishë e grisur.

ECTE TROTUAREVE TË VARFËRISË

Sa do të dëshiroja sot
Të jem një piktor i mirë,
Që, nga sytë e asaj plake,
Të nxjerr
Një pikturë vuajtjesh tona
Të përditshme.

Shoh dhe zemra më dhemb!
Shoh se si dridhet
Dora e saj e majtë...
(Të djathtën e ka humbur
Në ingranazhet e kohës!)

Është nëna e mikut tim,
I cili sot,
Vetëm si përmendore
Mund t'ia ofrojë
Përqafimin e bronzte të vjeshtës.

PREJ NJË TAVOLINE NË TJETRËN

Një tregim i varfër
Dhe dhimbja flokë çakërdisur,
Qenkan ulur
Në prehrin e asaj nëne
Dhe recitojnë *Poemën e Mjerimit!*

Për çdo ditë e në çdo kohë,
Nga sytë e saj të gështenjtë
Derdhen lumenjtë e trishtimit.
Derdhen si rrëke
Përbuzjet e tavolinave.

Një nënë, pa asnjë djalë,
Të vetmen vajzë që e kish pasur,
I kish mbetur diku,
Peng i gurtë,
Në Betejën e madhe të Koshares.

Ende vazhdon udha e saj e pambarimtë:
Kalon çdo ditë
Prej një tavoline në tjetrën,
Duke u takuar
Me mosmirënjohjet e njerëzve.

SONTE KAM DHEMBJE

Më lini të bisedoj
Me dhimbjen time të pashuar!
Kam kaq vite që vuaj
Si gjarpri i shtëpisë!
Ky gur
E ky mur,
Mbi dyqind vjet
Rënduan mbi kokën time!

O, më kuptoni, njerëz,
Sonte kam shumë dhimbje!
Këto varrë,
këto plagë,
Nuk kullojnë kot qelb e gjak!
Janë si ato të Gjergjit,
Që vuajnë për një dashuri motre.

Janë më të rënda!..
Jua them unë:
Janë më të rënda se ato të Gjergjit!
Se unë jam përmendore
E nëna ime
Po më rri te këmbët.
E unë s'po mund
As dorën t'ia çoj te balli!

PO LEHIN EDHE KALDRËMET E LASHTË TË ILIRISË

Biro, lëri ata qejfet e tu!
Unë nuk kam asnjë lek!
Qe shtatë ditë
E shtatë net të gjata,
nuk kam ndezur asnjë cigare.

Për bukë e kripë
S'po vuaj, biro!
Të kujtohet komshiu i vjetër?
Stelën e qenit
Ia ka mbështetur murit tonë.
Sa për bukë, disi po gjendem.

As për veshmbathje
Nuk po heqim keq.
Këtu, në qytetin e kinkalerive,
Ka me qindra dyqane
Që shesin mall të përdorur Gjeman.

2.

Jam më keq se asnjëherë më parë!
Të kam treguar
Se nëna jote më tradhtoi?
Iku sivjet. U ngjit te yjet.
Ndjesë pastë shpirti i saj!
Më la me gisht në gojë.
Kam mbetur fillikat vetëm, biro!

Me shtimin e derteve
Dhe të vetmisë,
Po më shtohet edhe duhani.
As dy paketa cigare
S'po më dalin në ditë.
Kurse për netët e gjata
S'po të them asnjë fjalë.

Nuk më ka mbetur shumë kohë.
Edhe unë, një ditë,
Do të udhëtoj te nëna jote.
Ndoshta atje, te yjet,
Na ripërtërihet dashuria.

3.

Sa për arkivol,
Mos e lodh mendjen.
Për të blerë një arkë të tillë,
E kam shitur veshkën e majtë.

Por ti, biro, mos ngurro:
Dërgomi ca lekë,
Le të më shkurtohen
Netët e gjata,
Ato të mospasjes asgjë,
përveç ca kujtimesh prej kashte.

Njëmijë djaj të zinj
Po lehin në kokën time!
Po lehin, biro,
Po lehin edhe kalldrëmet e lashtë Ilire !

FLINTE EDHE ZGJOHEJ TE PËRMENDORJA

Mbi një mermer të mjerimit
Duart e saja mbetën peng:
Përpos vetmisë,
Ajo s'kishte askënd.

Vetëm gurët e faltoreve
Dhe një murg
E njihnin atë Grua.

Nga duart e lodhura
Pikonin djersët
E viteve të përtypur.

Ajo s'kishte kënduar
Asnjëherë psalmet e vjetër,
Por faltoret e qytetit
E njihnin si një Grua
Me G të madhe.

Flinte e zgjohej te përmendorja
E ushtarit të harruar!
Dhe thuhet se, për çdo ditë,
Ia pastronte plagët e pashëruara.

I PËRKUNDTE DJEPAT E LAGJES

Doli si e përtërirë
Nga një përrallë e lashtë.
Në prehrin e saj
Prej rëre
Asnjëherë nuk përkundi kërthi.

Thonë se kurrë s'kishte qenë nënë,
Por, me një mallëngjim
Të padëgjuar,
I përkundte djepat e lagjes.

Përgatiti dy gjenerata për ushtri.
Aq shumë e donte atdheun,
Sa që kurrë s'lypi
Prej kësaj toke
Asnjë krodhe buke të thekur.

Dikur, më vonë, kur e zuri nata,
I shikonte dyert të mbyllura.
Dyer, ku me vite të tërë
Kish përkundur djepa!
I shikonte edhe duart
Dhe mollëzat e duarve,
Të rrudhura.

NË GOLGOTËN E VARFËRISË

Nëpër shëtitorët e zbehta
Parakalojnë rreshtat e gjatë.
Parakalojnë në grupe,
Kolona njerëzish
Me gjymtyrë të ndrydhur
Dhe duar të shtrira.

Këto pamje biblike
Shkasin si hijet e zeza.
Shkasin nëpër trotuare
Të pambarimtë.
Mos vallë është shfaqur lebra
Në golgotën e varfërisë
Dhe po na i turbullon shqisat?!

Më parë nuk kemi përjetuar
Asnjëherë
Karnavale kaq të dhimbshëm
E kaq morbidë,
Të gjymtyrëve
Që zvarriten nëpër trotuare
Si gjarpri i plagosur.

NDALU, MOJ UJKONJË E ZEZË

Ndal, moj ujkonjë,
Ndal!
Mos e kafsho
Aq pa mëshirë ashtin tim!

Nga sytë e të verbërve
Pikojnë si rrëshira
Dhimbjet e trishtuara!

Ndal, moj ujkonjë!
Mos më kafsho në këtë gjendje!
Mos je tërbuar, vallë?!
Përse e imiton njeriun?!

Ujkonjë e zezë!
Pa ngrënë asnjë kafshatë
Më dhemb arkivoli!
Nuk më pëlqejnë sonte aspak
Këto varreza të çrregullta!

Ndal, moj bishë e zezë,
Ti, bija e urisë,
Ndal,
Se do të djegin zjarret e ferrit!

DY PIKA TË LOTI

Dhe zjarri filloi
Ta lëpinte ashtin e shkëmbit.
Një pamje imponante
U shfaq
Në syprinën e kafshatës së mykur.

Atë çast u derdhën
Nga sytë e përlotur të hënës
Dy pika loti.
Në horizont
Zgërdheshej bisha.

Edhe dy hapa të rëndë
Deri te varri i vithisur:
Dy arkivole
Në një varr të zbrazët,
Tri vezë të qullëta
Fluturuan nga çerdhja e qyqes.

VETËM URIA, KJO BISHË E PANGOPUR

Atë natë s'kishim më
Përse të flisnim.
Dikush ia theu kurrizin karnavalit,
I cili zvarritej
Si zvarranikët parahistorikë.

Disa qyqe të sëmura
Këndonin mbi një rrasë të kuqe.
Këndonin një këngë
Alegorike për urine.
Askush atë natë
S'shtiu gjë në gojë.

Vetëm uria, kjo bishë e pangopur,
Dhe dy zogj,
Qëndrojnë në çerdhen e djegur.
Qëndrojnë me sqepa të hapur.
Mbase kërkojnë lëmoshë
Nga sy zbrazëtia e mjerimit.

Prishtinë, 21 prill 2019.

KJO HESHTJE METAFORIKE

Këtu, në këtë qytet
Mistik,
Nuk paska mbetur asnjë ëndërr!

Herët sot, e prenë biletën
Këta banorë të pafat...
Nuk dinë
As për ku janë nisur.

Kryesore, kokën ndër duar
Dhe: Ku të dalë,
Të dalë!
As në ferr s'do ta kenë më keq!

Këtu, në këtë qytet mistik,
Si në këngët homerike,
Përsëriten tragjeditë,
Ripërsëriten vdekjet e lashta.

Vetëm skelete
Dhe duar të zgjatura
Paraqiten me imazhe të trishtuar.
Kjo heshtje alegorike
Po i mbyt zogjtë
Që në gjenezë.

QË NË FILLIM TË UDHËS

Vonë kuptuam se sa trishtueshëm
Vdiqën ëndrrat.
Kur deshëm të ecim,
Në fillim të udhës,
Na e ndalën ecjen lukunitë.

Provuam të ndryshonim itinerarin.
Por, ku të shkojmë?!
Si mund të jetojmë
Me ëndrrat e huaja
Nëpër xhepat tanë të grisur?!
S'tringëllin në këta xhepa
Asnjë lek i mykur!

Në cilën derë të trokasim,
Kur vetë i mbyllëm
Të gjitha portat e shpresës?!

Kjo natë e gjatë,
si ajo e Shën Bartolomeut!
Sa gjak pangopshëm
I paskan mprehur thikat
Ata që
Përjetësisht i përgjojnë shtigjet!

ME AVAZIN E VJETËR TË SKAMJES

Një pikëllim i thellë,
Ia numëronte
Çastet më delikatë.

Shikonte në pasqyrë të kaluarën e saj
Dhe i shkulte flokët,
E trishtuar.

Herë qante
E herë dukej se këndonte
Një elegji të lashtë.
Këndonte për të ardhmen,
E cila i paskësh humbur të gjitha rrugët.

Nëpër skutat e lagjes,
Në shuplakat e kalimtarëve,
Parashikonte fatin e tyre.
Parashikonte dhe qeshte me ironi.

Një ditë iu kujtua se duhej të shihte...
Fatin e vetvetes...
Qeshte si e çmendur
Dhe vazhdonte te qoshja
Avazin e përhershëm...
Të barkut bosh.

TRI A MË SHUMË QYQE

E pashë e m'u duk se tha:
Sot s'do të ketë bukë për ne.
Atë kafshatë të përditshme,
Këtë herë,
Na e paska ndalur edhe Zoti!

Tri e ndoshta katër,
A më shumë qyqe,
këndonin në të njëjtin rrap.
Këndonin një këngë
Të kamotshme për urinë.

Nën degët e skamjes
Ishin ulur me qindra njerëz
Dhe dëgjonin
Refrenin e përditshëm të bukës:
Ku-ku! Ku-ku!

AJO E DONTE PËR SË TEPËRMI JETËN

Ecte e kërrusur.
Me mjekrën e saj të gjatë
Prekte tokën:
Një mandatë e panjohur
S'linte dritë me pa.

Për çdo ditë e takoja te Ura,
duke kundruar
lojën e guralecëve,
kah kacafyten me dallgët
e shthurura të Lumëbardhit.

Ju thashë se për çdo ditë
E takoja te Ura atë nënë...
Sot, për befasinë time, mungonte.
Më thanë se kishte shkuar
Për të blerë një arkivol.

Kurrë më nuk e pashë,
As te Ura e Gurit, as te dallgët,
duke biseduar me koralet e kaltër.
Ajo e donte për së tepërmi jetën
Dhe... ia adhuronte jetës ngjyrat.

PËRMENDORET MERITOJNË MË SHUMË

Frikën, trishtimin, skamjen,
I bartte mbi shpatullat e lodhura.
Nuk kishte me kë
Ta mbante mandatën.
Nga ofshamat e saja
Dilte një zjarr
Që nuk shprushej kurrë.

Për befasinë e të gjithëve,
Ajo nënë, vërtet e madhe,
I stoliste pa ndërprerë përmendoret
Me tufa lulësh:
Për çdo ditë vendoste atje nga një tufë,
Që fishkej brenda ditës...
Nga dhimbja.

Të gjithë lekët e lypur
I shpenzonte
Në lulishten më të afërme!
Ajo jetonte duke blerë lule
Dhe, rast pas rasti,
S'mungonte së përsërituri:
Përmendoret meritojnë më shumë.

KACAFYTEN INSTIKTIVISHT

Me dhimbje në ije
Dhe trastë grisur,
Kalonte nëpër shëtitorët e skamjes.
S'kishte asnjë shpresë
Për të nesërmen e largët.

Kalimtarët, si zakonisht,
Shikojnë me mospërfillje
Në drejtim të vitrinave,
Ku kukullat e dyllta
Reklamojnë
Brekët e përditshmërisë.

Duke u drejtuar për te taverna,
Shtrëngonte me dorën e majtë
Copën e mykur të bukës.
Tmerrësisht u frikësohej qenve endacakë,
Të mos ia grabisnin shujtën e mbrëmjes.

Kështu, kjo nënë
Dhe shumë nëna të tjera,
Kacafyten me bredhësit e rrugëve.
Kacafyten pavetëdijsëm,
Për të mbijetuar... deri nesër.

GOGËSINTE EDHE MLLEFI NJERËZOR

Këpucët e zeza
E të zhytura në pluhur,
Të qullura si qullët e kuajve,
Nga djersët e rrëkeshëm ,
Imitonin zërin e mistershëm
Të skamjes.

Dëgjohej një shllap-shllup
Kalldrëmeve ilirë,
Kurse rropullitë kryengritëse
Nuk i ndjenin gogësimat.
Gogësinte
Edhe mllefi njerëzor.

Ai njeri i respektuar,
Dikur kishte qenë mësues.
Por, ja që fati,
Tërësisht e ndryshoi itinerarin,
Duke ia kafshuar pa mëshirë ashtin,
E ashti pësoi metamorfozë.

KY REFREN I PADOBISHËM I TRISHTIMIT

U nis për diku.
As vetë s' e dinte se për ku qe nisur.
Pas atij (apo asaj),
Shkonin edhe gurgullimat e zorrëve.

Kryengritje rropullish!
Sandalet e grisura,
Si peshqit e ngordhur hapin gojët,
përpijnë pluhurin e përditshmërisë.

Dielli i pamëshirshëm i politikës,
Si një saç u rri mbi krye.
Nga marramendja
U bie të fikët trungjeve të kalbur.

Kështu, ky refren i trishtimit,
Për çdo ditë përsëritet
Në interval me gurgullimat,
Imitim protestash nëpër rrugë.

MË DËRGOJNË DERI NË THEQAFJE

Dridhen si degët e thara!
Më kujtohet kur më tha një ditë:
Biro, unë eci me tërmete në zemër.
Shiko se si dridhen
Duart e kalbura të mështeknës!

Kam dy sy, dy veshë dhe plot shqisa të tjera,
Por nuk dëgjoj
E s'shoh asgjë, biro!
Më dërmuan përfundimisht
këta tërmete të urisë!
Më bënë rrafsh me dheun!

Nga thonjtë e mi,
Si të gishtave, po ashtu edhe të këmbëve,
Derdhen lumenjtë e gjithë dynjasë.
Derdhen dhe më marrin me vete.
Më degdisin deri në theqafje
Dhe sërish më kthejnë
Në epiqendrën e tërmeteve.

GËRVIMAT DHE VIGMAT E RROTAVET

Aq shumë punë kanë
Nekrologët e lagjes sime,
Dhe aq delikate,
Sa që u duhet t'i përtypin të vërtetat,
Edhe gënjeshttrat e kripura,
Mbi fatet ose pa fatet e banorëve.

Sidomos të atyre
Që i shtrijnë duart e mishta...
Që i shtrijnë drejt diellit,
I cili asnjëherë nuk ua ngrohu fatet.

Nekrologjia, kjo zeje e çuditshme,
Merret vetëm me vdekjet e njerëzve!
Kurse të gjallët,
As që i përfill si qenie njerëzore.

Kur vdesim, mbi një araba arkaike,
Së cilës i dëgjohen gërvimat
Dhe vigmat e rrotave,
Duke përcjellë me kumte mortarë
Deri te nekroplet e vithisur,
Ëndërrojmë jetën,
Me një diell sadopak të pranueshëm përsipër.

NË TË NJËJTIN NEKROPOL

Ndoshta rastësisht pashë të shtrirë
Dorën e saj të rrudhur,
e cila, me siguri,
dikur ka ledhatuar për mrekulli.

Mbase sot ato rrudha
Po vuajnë shpirtërisht!
Nga një anemi tronditëse ditore ,
Po vuajnë si gjarpri në shkretëtirë!

Afër njëzet vjet
Duart e saja patën vrapuar nëpër zbrazëti.
Me siguri ka harruar
Si priten e përcillen miqtë.

Sa herë që kalon pranë varreve,
Shikon burrin e saj
Dhe dënes, duke pyetur mëdyshas:
Kush, vallë, shtrihet pranë tij?!

Qan dhe rikujton,
Kur i premtonin njëri-tjetrit
Se do të varroseshin së bashku
Në të njëjtin nekropol.
Qoftë edhe... skajshmërisht i varfër!

NËN NJË PLASMASË TË ZEZË

Kam përshtypjen se arrita në fund të rrugës.
Tej atyre shkurreve,
Një grua nënë,
Rri mbuluar nën një plasmasë,
Kurse shiu i trentë
Troket në dritaret e mbyllura.

Me ditë të tëra e javë
Kruspulloshur nga pleqëria.
Skamja dhe stërkalat
Çmendurisht trokasën në portat e mbyllura
Te një plasmasë e zezë ,
Kurse veriu i shtron lisat në shtrojerë.

S'dihet më nëse duart
Do t'i pushojnë ndonjëherë së dridhuri.
Dridhet e kruspulloshur,
Dridhet, në tentoftë të rrijë ndenjtur.
Dridhet nënë-mjera
Nën mbulesën sterrë të zezë!

Cikli i tretë
Duart e zhagmitura

NJË HËNË E DYSHIMTË

Kush e mbolli këtë pemë të egër
Në kërthizën e sëmurë të tokës?!
Megjithatë,
Pema e mbjellë me rrënjë në qiell,
S'mund të çelë asnjë lule,
Përpos trishtimit.

Disa hije të zbehta morbid
Sillen vërdallë
Mbi një katakomb të lashtë.
Varret këtu,
Për çdo ditë
E në çdo kohë,
Nuk i ndalin trishtimet e thekshëm.

Mbrëmë mbi krahët e zogjve,
Të verbër, endacakë,
Fluturuan yjet e krejt galaktikës.
Fluturuan prej shtatë deteve
E shtatë maleve të thepisur.
Një hënë e dyshimtë
Abortoi një lule prej guri
Kur e pa ekuinoksin t'i afrohej.

KUR I PAMË ANIJET E VDEKURA

Ishte koha asnjënëse, kur filloi
Me çelë lule të kaltra lulesyri.
Mbi mermerët e murmë,
Një trëndafil bojëgjaku
Vendosi gurët e atdheut tim.

Dy lule të bardha
Dhe një shebojë, si dy këndesa,
Fluturuan mbi qiçin e thyer të anijes.
Në perëndim zgjohej, herë batica,
Herë stuhia kryengritëse

Kur i pamë anijet të vdekura,
Na u kujtuan disa këngë:
Që nga kohërat e lashta,
Kënga e trenave të sëmurë
Dhe kënga e vaporëve barkshpuar.

Furtuna më kurrë nuk erdhi
Në kohë të caktuar,
Siç vinte gjithmonë.
Orën e rërës, si dhe atë të diellit,
I zëvendësuam me orët e shkretëtirës.

NË SHESHIN E QYTETIT

Të gjithë dezertorët
Ikën nga fushëbeteja.
Flamujt e braktisur nga të dyja palët,
Mbetën si hunj të ngulur
Në parzmën e tokës mëmë.
Vorbulla dukej si vesh gjilpëre.

Një frymë e fortë doli nga honi,
doli dhe vrapoi rrugicave qorre.
Atë ditë, llafe me qindra
Nëpër mëhalla e ngushta parakalonin.
Frymëmarrja e qiparisave
Përjetoj një tërmet të paparë.

Dikur vonë, shumë vonë,
Pamë se si zbritnin
Gurët dhe drurët nga mali.
Zbritnin si ortek dëbore.
Në sheshin e qytetit,
Kolona flamujsh , dalë në pritje.

VDESIN VETËM FRIKACAKËT

Shikoni atje lart te mjegullat.
Nga majat e atyre majave,
Një ditë,
Si ortek i bardhë dëbore,
Do të zbresin dykrenorët.

Do të zbresin
Me nga një flamur prej gjaku,
Për ta valëvitur
Në altarin e shenjtë të atdheut!
Do të zbresin nga qiejt
Heronjtë e kombit!

Ju kujtohet kur kam pohuar
Se atje nuk ka vdekje?!
Vdesin vetëm frikacakët!
Për çdo ditë vdesin nga pak,
ata që kanë si helm
frikën në gjak!

ZVARRITEMI HORIZONTALISHT

Për çdo ditë
Njerëzit mendojnë
Se po vriten pak nga pak.
Herë e ndjejnë vdekjen e tyre,
Nga tinëzarja dora e mikut
E herë nga brutalja dorë armike.

Një ditë ecim vertikalisht,
Kurse ditën tjetër,
Papandehur,
Zvarritemi horizontalisht.
Zvarritemi,
Deri sa ta përbuzim vetveten.

SA HERË SHIKONIM DRITËN

Me duart e mia të rrudhosura,
I preka, me një prekje delikate,
Mermerët e kuq të Kosovës.
Kuj si gjaku i mëllenjave!
Te selvitë e djegura,
Me mallëngjim qante një nënë.

Asnjëherë s'kuptova
Në cilën kohë po jetojmë.
E sotmja më duket tepër e largët,
E nesërmja,
Një nocion i paarritshëm,

Dielli këtu kurrë nuk lind
Kur duam ne.
Lind kur u teket të tjerëve!
Sa herë ia shikojmë dritën,
Befasisht qielli
Na errësohet mbi kokë .

.SI NË KOHËRAT MË TË LIGA

Dhimbje dhe sërish dhimbje!
Si t'i shëroj sonte
Këto plagë të padukshme?!
Një qyqe,
E mbas saj shtatë të tjera,
Mbrëmë kënduan te shelgu i pikëllimit.

Këngë qyqesh e asgjë tjetër!
Kjo sternë dritëpakët,
Me vrushkujt e saj të mugët,
Si nëpër ujë të turbullt,
Tmerrësisht po lëron
Nëpër bebëzat e mia të sëmura.

Sërish disa të lehura
U dëgjuan
Në disharmoni me të rrahurat e kamberës.
Kamberorja heshti
Si në kohërat më të liga.
Heshti dhe s'bëzajti më,

SA QË MBETËM SHURDHMEMECË

A thua, vallë, ju kujtohet,
Kur ju pata thënë, në një rast,
Se ëndrrat
Nuk janë zbulimi ynë?!

Janë vegime
Më se të hershëm.
U zbuluan, qysh kur etërit tanë,
mbi një gur të djegur,
filluan ta pjekin mishin.

Që nga ajo kohë,
Pamë disa lloje ëndrrash:
Nga më të brishtat,
Deri te ato më trishtueset.
Madje, edhe se vetë zhgjëndrrat.

Gjithsesi,
Shumë ëndrra kemi parë.
I përjetuam, edhe në ëndërr,
Të gjitha torturat e zhgjëndrrave,
Aq sa mbetëm shurdhmemecë,
Zgjuar edhe fjetur.

Prishtinë, 22 prill 2019.

LAHESHIN NËN STËRKALAT E RREBESHTA

Nga që nuk mësuam dot
Ç'të bëjmë me vetveten,
Jemi ulur në pluhur
Dhe lutemi,
Pa e ditur cilit Zot po ia drejtojmë lutjet,
Për larje mëkatesh.

Një tjetër diell,
Kube e përskuqur,
Rri mbi kokën tonë tullace.
Rri dhe kundron hapësirën boshe,
Sepse vetëm në boshllëk
I gjen dromcat e humbura të orbitës.

Sot, tërë ditën nuk ra shi:
Gjelbërimi vuajti nga etja,
Ndërsa kaktuset e egër të shkretëtirës,
Laheshin në oazën e kujtimeve.
Laheshin cullak
Nën stërkalat e rrebeshta të shiut.

DUART E ZHAGMITURA

S' shoh asnjeri,
Në këtë zbrazëti
Korridoresh të errët!
Pasqyra konkave shikon
Veç duart e mia, të zhagmitura.

Një hije ekstreme
Sillet rreth kokës sime.
Nëpër muret e lagësht
Rrotullohet saltoja e vdekjes.

Duken si të ngjizura:
Korridori, heshtja dhe sterna.
Një bashkë ngjizje e përsosur,
Në guallin vdekjesjellës të heshtjes.

Më tutje, afër dhomës së fjetjes,
S'kanë të ndalur burimet e lumenjve.
Fluturat e fëmijërisë
Paskan dalë, ndërkaq,
Nëpër luadhet e kositur!

TE VARRET E ETËRVE

Mendova se ishte çasti i fundit
T'i ripërtërimë ëndrrat.
Një lumë i çmendur
Derdhej
Në kundërshtim me të gjithë ligjet.

Nëpër lagjet e muhaxhirëve
I kishin djegur kavakët.
Asnjë njeri më
Nuk mbolli kujtimin e dhimbjes
Te varret e etërve .

Një zë i lashtë, si të ishte ndrydhur
Nga ingranazhet,
Dëgjohet në honin e kujtimeve.
Dëgjohet, thua se buron
Nga një det i pafund trishtimesh.

Dy gra, me flokë të shkukur
Nga rrënjët e dhimbjeve,
Vrapojnë, duke shkelur papërfillshëm
Mbi ferrat e kohëve të harruara.

E NXORËM BASMËN E TRËNDAFILTË

Pas gjithë e gjithë këtyre katrahurave
E peripecive,
Kuptuam që atdheu ishte një flutur,
Ose zog pa çerdhe,
Ku uleshin çdo ditë pretarët,
Për t'ia gërryer palcën.

Ne asnjëherë nuk patëm kuptuar:
Çfarë kuptimi ka
Një flamur që e valëvit era?
Ai për ne, s'ishte veçse një cope arnë,
Me të cilën s'arnohej dot asnjë gllënjjë
dhimbje.
Le më, t'i uleshim në gjunjë e ta puthnim!

Ky atdhe, kjo tokë e etërve,
Tymosur nga mijëra flamuj të huaj,
Nuk na mësonte dot si t'i dashurojmë
Sinorët dhe gurët e maleve.
Me një fjalë, s'ishim veçse qiraxhinj
Në vatrat tona të hershme.

Por, prapëseprapë,
Në vetëdijen tonë të thellë,
Ose, më mirë me thënë,
Nga kujtesa jonë e lashtë sa vetë lashtësia,
E nxorëm basmën e trëndafiltë
Dhe e shpërfaqëm në sy të diellit
Me një dykrenor të madh te balli.

PËR T'I RINGJALLUR DYKRENORËT

Këto erëra që na godasin
Mu atë çast
Kur nuk presim asnjë furtunë,
Janë si një shpatë e topitur,
E cila brutalisht
Ngulet në gjak si gjilpërë e ndryshkur.

Janë ca tërmete miniaturë,
Që na e tronditin
Shpirtin e thyer nga tufanet,
Kur zëri i erës
Rrapëllon nëpër damarë e shpirtit,
I cili s'i duron dot goditjet.

Breshëri i mbrëmshëm i theu në heshtje
Xhamat e kujtesës
Dhe nuk na la asnjë rrugëdalje,
Që të shkojmë
Deri te portat e hekurta,
Për t'i ringjallur dykrenorët .

VETËM ZËZËLLIMAT MONOTONE

Nuk di, pa dashje
Ose kundër dëshirës sime,
Ua mbylla të gjitha portat
Mysafirëve,
Të ftuar dhe të paftuar.

Atë çast binte një shi i egër.
Në mollëzat e mia
Të zhubrosura
Si gazetatat e një stine të vrazhdë,
Binte, në litarë të pambarimtë.

Eca edhe dy mijë vjet
Nëpër urën e mëkateve.
Askurrë nuk i gjeta të hapura
Dyert e parajsës:
Qenë të mbyllura me dyllin e Odisesë.

Në ecje e sipër, vitet u rënduan,
Thua se në rropullitë e uritura
Nuk gjendet asnjë mushkonjë.
Vetëm zëzëllimat monotone
Ushtojnë nëpër shqisat e dërrmuara.

KURSE BRESHËRI I ZI

Ka vite e vite
Që, as miqtë e largët,
As ata të afërt,
Nuk trokasin, as në dyert
E as në dritaret e hapura.

Një vdekje e bardhë
Duket në horizontin e kundërt.
Vjen duke bartur
Një arkivol,
Të blerë para shumë deceniesh.

Vonë më erdhi ndërmend
Se njerëzit
Më së shumti i frikohen vdekjes:
Copës së ngrirë të akullit,
Më së shumti frikohen
Nga e pritura.

Kurse breshëri i zi
Rrapëllon mbi teneqet e llamarinta.
Rrapëllon pa pasur drojë
Se mos i zgjon etërit tanë krenarë,
Që s'u frikuan nga asnjë lloj vdekjeje.

LINDUR NGA ZJARRET E PERENDIVE

Sonte nuk kam droje
Nga asnjë tufan.
Nuk ekziston vdekja,
E cila mund të më kërcënojë mua!
Nuk merret kjo kala,
Edhe nëse i lëmë portat të hapura.

Sonte nuk ka vdekje për fluturat,
as për zogjtë e fëmijërisë!
Vdekja, ky nocion i padukshëm,
S'do të trokasë tinëzisht
Në dritaret e hapura,
As në dyert e pambyllura.

Nëpër shpirtrat e vetëtimave
Do t'i mbjellim rrapet
Që nuk u frikohen,
As zjarreve, as tufaneve!
Ky popull është vetë zjarri,
Lindur nga zjarret e perëndive.

Prishtinë, 23 prill 2019

Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime, kryesisht me poezi ,filloi të merret që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën “Pionieri”, më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar “Lulëkuqet e Kosovës”. Në kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja “Ngjyra e kohës”, në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa Antologji dhe në librin “Kosova letrare” të poeteshës Monica Mureshan.

Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995 nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002.

Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i Shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. “Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4. “Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëdarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
10. “Thirrje e gjakut”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu” Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.

14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
- 18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
- 26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.

30. "Shtegu i mallit", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. "Korniza e thyer", Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. "Zgjimi i gjëmës", Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
33. "Vallja mistike", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
34. "Merre kodin", Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35. "Letër atdheut" poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. "Tejdukshmëria e shiut", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. "Përtej teje", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. "Sa afër e sa larg", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. "Vallja e zanoreve", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. "Ikja e eshtrave", Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
41. "Kalorësit e mjegullave", Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. "Hingëllimat e shiut", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. "Kur pemët i ndërrojnë këmishët". Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
44. "Mirëmëngjesi Imzot", Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. "Kafshimi i mikut", Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
50. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
- 75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

78. “Pyesni zogjitë në ikje”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
- 79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
82. “Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
83. “Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
84. “Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
85. “Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
86. “Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
87. “Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
88. “Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
89. “Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
91. “Krakëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
93. “Atdheu i paçmuar” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

94. "Psalm i harruar ", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
95. "Për kë po bie moj kambanë", Poezi Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
96. "Mbi flokët e ullukëve", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
97. "Menatë vijnë lejlekë", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
98. "Loti i gotës së dehur" , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
99. "Stina asnjansë", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
100. "Dëneste bashkë me erën" Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
101. "Druri i pikëlluar", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
102. "Një grusht dashuri", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
103. "Lëreni zërin tim", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
104. "Shi në qytetin tim", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
105. "Si trenat e verbër ", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
106. "Zjarri i malli tim ", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
107. "Kur teshtin era", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
108. "Mbi shpirtin e erës pagane", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014

109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 110.”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
- 123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015

124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “ Nëpër brigjet e kujtesës” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
- 135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
- 136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
138. “Nuk i them unë dot kësaj liri” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016

140. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
141. “Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016
142. “Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë, 2017.
143. “Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2017
144. “Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë, 2017
145. “Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2017
146. “Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
147. “Një stinë delikate”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
148. “Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2017
149. “Ishim të lumtur si gjinkallat”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
150. “Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2017
151. “Telat e shirave ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
152. “Një stuhi prej bryme”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2018
153. “Sonte s’ka dashuri ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
154. “i shëmbëllente pluhurit kozmik”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2018
155. “Llamburite atdheu i plagosur” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018

- 156.“Gurët e pjekur shtatë herë” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
157. “Kur të dalë nga kjo stinë” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 158.“Ishin thyer te gjitha urat ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 159.“Gjethi i këputur në vjeshtë ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 160.“Ti mundesh nëse do” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 161.“Pëllumbat prej rrufeve”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
162. “Diku në zbrazëtinë e ndërgjegjes”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 163.“Retë e dendura të kujtesës ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 164.“ Pak diell e shumë acar”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 165.“Kur kyçen yjet e harresës ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 166.“Nga pragjet e shtëpive”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 167.“Fluturat e djegura ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 168.“Përtej asaj peme”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 169.“ Kuajt e mjegullave”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 170.“Po të ishte ndryshe ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 171.“Kur kthehen zogjtë e shiut ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019

172. “Mes gishtave të hijes”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
173. “kush i theu xhamat e shiut”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
174. “Poemat e dhembjekrenarisë ”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
175. “Marsi i çmendur në dy kohës”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
176. “ Kur dënesin varret”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
177. “ Mos më uroni udhë të mbarë”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë
178. “Nuk mjafton të kesh vetëm emër ”,
poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
179. “Portat e mbyllura me dyllë ”, poezi, Shtëpia
Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
180. “Deri në baladën tjetër ”, poezi, 2020 Shtëpia
Botuese TRENDI”, Prishtinë
181. “ Bleta e kaltër”, poezi, Shtëpia Botuese
TRENDI”, Prishtinë, 2020
182. “_Nën vezullime yjesh ”, poezi, Shtëpia Botuese
TRENDI”, Prishtinë, 2020
183. “Duart e zhagmitura_ ”, poezi, Shtëpia Botuese
TRENDI”, Prishtinë

PËRMBAJTJA**Cikli i parë****Ti ishe pema.....13**

Mungove në ekzistencën e fluturës.....	15
Yjet na shikonin me xhelozi.....	17
Vetëm kori i bretkosave.....	19
Ti ishe pema.....	20
Sa i thellë është deti i fjalëve të thëna.....	21
E pashpjegueshme deri në pafundësi.....	22
Sa ishte kënaqësi të qanim në shi.....	24
Që kishin nga dy emra.....	25
Aq shumë e deshëm shiun.....	26
Të uriturit e mëngjeseve.....	27
Na ngroh ai zjarr i Olimpiti.....	28
Fluturoi lartësive.....	29
Ti je gjelbërimi im e dashura ime.....	30
Pusho ,moj erë pusho,.....	31
Fundosemi si anijet kozmike.....	32
Nga një puthje shumëshkatërruese.....	33
Nëpër guajt e kërmijve.....	34
Asnjëherë nuk pata zemër.....	35
Fluturat e kaltra të puthjeve.....	36
Dy yje në horizont.....	37
Kështu kjo botë si në kurth.....	38
Dashuriam si lakej e si mbret.....	39

Cikli i dytë**Përmendoret meritojnë më shumë.....41**

Një nënë me gjinj prej rëre.....	43
Poeti i moçëm i skamjes.....	44
Dëgjohen lehjet e lashta.....	45
Me një këmishë të grisur.....	46
Ecte trotuareve të varfërisë.....	48
Prej në tavoline në tjetrën.....	49
Sonte kam dhembje.....	50
Po lehin edhe kalldrëmet e lashta Ilire.....	51
2.....	52
3.....	53
Flinte edhe zgjohej te përmendorja.....	54
Përkundte djepat e lagjes.....	55
Në golgotën e varfërisë.....	56
Ndalu moj ujkonjë e zezë.....	57
Dy pika të zeza loti.....	58
Vetëm uria kjo bishë e pangopur.....	59
Kjo heshtje metaforike.....	60
Që në fillim të udhës.....	61
Me avazin e vjetër të skamjes.....	62
Tri a më shumë qyqe.....	63
Ajo e donte për së tepërmi jetën.....	64
Përmendoret meritojnë më shumë.....	65
Kacafyten instinktivisht.....	66
Gogësinte edhe mllefi njerëzor.....	67
Ky refren i padobishëm i trishtimit.....	68
Më dërgojnë deri në theqafje.....	69
Gërvimat dhe vigmat e rrotave.....	70
Në njëjtin nekropol.....	71
Me një plasmasë të zezë.....	72
Cikli i tretë	
Duart e zhagmitura.....	73

Një hënë e dyshimtë.....	75
Kur i pamë anijet e vdekura.....	76
Në sheshin e qytetit.....	77
Vdesin vetëm frikacakët.....	78
Zvarritemi horizontalisht.....	79
Sa herë e shikonim dritën.....	80
Si në kohërat më të liga.....	81
Sa që mbetëm shurdhmemec.....	82
Laheshin nën stërkalat e rrebeshit.....	83
Duart e zhagmitura.....	84
Te varret e etërve.....	85
E nxorëm basmën e trëndafiltë.....	86
Për t'i ringjallë dykrenorët.....	88
Vetëm zëzëllimat monotone.....	89
Kurse breshëri i zi.....	90
Lindur nga zjarret e perëndive.....	91

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem

Duart e zhagmitura / Adem Zaplluzha. -
Prishtinë : Trendi, 2020. - 109 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951 -757-54-6